

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIV, nr. 7895
E martë, 1 tetor 2024
Çmimi 0.50 €

Komuna e Prishtinës
liron nga pagesa e
trafikut urban invalidët e
luftës së UÇK-së | FAQE 7



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

27 VJET. PROTESTA STUDENTORE E 1 TETORIT 1997 MOBILIZOI POPULLIN | FAQE 4-5



1 tetori i vitit 1997 ishte një moment kthesë në historinë e Kosovës. Atëkohë studentët, profesorët dhe qytetarët i mbushën rrugët e Prishtinës. Ajo protestë pati efekt të madh sepse e gjithë bota ktheu vëmendjen te

Kosova, te fati i shqiptarëve dhe shembulli se si okupatori serb vepronte mbi rininë shqiptare, se si po mudohej të shtypte çdo lëvizje e cila kërkonte drejtësi, liri dhe pavarësi për popullin shqiptar. Po ata studentë iu

bashkuan edhe radhëve të UÇK-së. Studentët dhe pedagogët pjesëmarrës në protestën e 1 tetorit 1997 shënuan një faqe të ndritur të historisë së rezistencës së Kosovës drejt lirisë dhe pavarësisë


SBASHK-U DORËZON NË KUVEND PETICIONIN PËR NDRYSHIMIN E LIGJIT PËR SKEMAT PENSIONALE | F. 3



NATO DISLOKON TRUPA NË KOSOVË DHE MAQEDONI TË VERIUT | F. 3



AKTUALE



OKB-ja: DY E TRETA E NDËRTESAVE NË GAZË JANË DËMTUAR NGA LUFTA | F. 2

KAJA KALLAS NË VEND TË BORRELLIT, ÇFARË E PRET KOSOVËN NË DIALOG? | F. 5

HAPET THIRRJA PËR STUDIME TË DOKTORATËS, NJË STUDENT DO TË MBËSHTETET 8 500 EURO | F. 3

EKONOMI


HAPËSIRAT E GJELBRA PUBLIKE, 'EC MA NDRYSHE': 15 KOMUNA ME PERFORMANCË NËN MESATARE | F. 8

GËRHXHALIU: SUBVENCIONOHEN PAJISJET PËR NGROHJE ME ENERGI ELEKTRIKE NË KOHËN KUR PARALAJMËROHET KRIZË ENERGETIKE DHE NGRITJE E ÇMIMEVE | F. 8

KULTURË

BASHKIA E PUKËS NDERON FIGURËN E PROF. DR. EQREM ZENELAJ ME TITULLIN MË TË LARTË TË QYTETIT | F. 10

Nga: FADIL HYSENI (Kabash) Pukë



RENOVA
Maqedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
E-mail: renova@mt.net.mk
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË
044/256-051
044/367-061
028/532-617

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë.
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

OKB-ja: Dy e treta e ndërtesave në Gazë janë dëmtuar nga lufta

GAZA, 30 SHTATOR - Dy e treta e ndërtesave në Rripin e Gazës janë dëmtuar ose shkatërruar që nga fillimi i luftës në Gazë në tetor të vitit 2023, sipas Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB). Në përditësimin e fundit të raportit vlerësues të dëmeve, Qendra Satelitore e OKB-së (UNOSAT) tha se imazhet me rezolucion të lartë të mbledhura më 3 dhe 6 shtator tregojnë një përqendrim të dukshëm. "Kjo analizë... tregon se dy të tretat e totalit të strukturave në Rripin e Gazës kanë pësuar dëme", tha UNOSAT. "Totali prej 66-përqindësh të ndërtesave të dëmtuara në Rripin e Gazës përfshin gjithsej 163 778 struktura", thuhet tutje në vlerësimin e UNOSAT-it.

Vlerësimi paraprak, bazuar në imazhe nga fillimi i korrikut, kishte përcaktuar se 63 për qind e strukturave në këtë territor palestinez kishin pësuar dëme. Përditësimi i së hënës bëri me dije se dëmet tani përfshijnë "52 564 struktura të shkatërruara; 18 913 struktura të dëmtuara rëndë; 35 591 struktura të mundshme të dëmtuara; dhe 56 710 të prekura mesatarisht". UNOSAT dhe Organizata e Ushqimit dhe Bujqësisë e OKB-së raportuan, gjithashtu, se rreth 68 për qind e fushave të kulturave të përhershme në Gazë treguan një "rënie të ndjeshme në shëndetin dhe dendësinë" e tyre në shtator. Sulmi i paprecedentë i Hamasit ndaj Izraelit më 7 tetor rezultoi në vdekjen e 1 205 personave,



kryesisht civilë, sipas një bilanci të AFP-së, bazuar në shifrat zyrtare izraelite që përfshijnë pengjet e vrara në robëri. Ofensiva ushtarake hakmarrëse e

Izraelit ka vrarë të paktën 41 615 persona në Gazë, shumica prej tyre civilë, sipas shifrave të ofruara nga ministria e shëndetësisë e drejtuar nga Hamasi, grupi

palestinez i shpallur organizatë terroriste nga ShBA-ja dhe BE-ja. Kombet e Bashkuara e kanë përshkruar këtë numërim si të besueshëm. UNOSAT, pjesë e Institutit të OKB-së për Trajnim dhe Kërkim (UNITAR) në Gjenevë, thotë se analiza e saj e imazheve satelitore ndihmon komunitetin humanitar t'i vlerësojë përmasat e dëmeve nga konflikti dhe ndihmon në formësimin e përpjekjeve të ndihmës emergjente. "Në vitin e fundit ekipi i UNOSAT-it ka punuar pa pushim për të ofruar informacione të sakta dhe të përditësuara mbi ndikimin e konfliktit në ndërtesat dhe infrastrukturën në Gazë", tha drejtori ekzekutiv i UNITAR-it, Nikhil Seth.

Le Pen në gjyq për keqpërdorim të pretenduar të fondeve të BE-së

PARIS, 30 SHTATOR - Marine Le Pen, udhëheqëja e partisë së ekstremist të djathtë në Francë, Tubimi Kombëtar (RN), mohoi të ketë bërë ndonjë shkelje ligjore gjatë një seance në gjyq më 30 shtator në Paris, ku ajo dhe 26 persona të tjerë u akuzuan për keqpërdorim të fondeve të Bashkimit Evropian. Ajo tha se RN-ja "nuk ka shkelur asnjë rregull politik apo ligjor të Parlamentit Evropian" dhe premtoi t'u paraqesë gjyqtarëve "argumente jashtëzakonisht të forta dhe të qëndrueshme". Pothuajse një dekadë pas fillimit të hetimeve, gjyqi mund t'ia ndalojë Le Penit të mbajë poste publike deri në 10 vjet shkaku i akuzave të cilat ajo i mohon. Le Pen, e cila prej kohësh ka punuar për ta pastruar imazhin e partisë së saj, humbi përballë Emmanuel Macronit në raundin e dytë të zgjedhjeve presidenciale të Francës në vitet 2017 dhe 2022. Ajo shihet gjerësisht si një nga favoritët kryesorë për zgjedhjet e ardhshme më 2027. Zyrtarët dhe punonjësit e partisë,



ish-deputetë dhe asistentë parlamentarë, akuzohen se kanë përdorur paratë e destinuar për punë parlamentare të BE-së për ta paguar stafin që punonte për RN-në, që në atë kohë quhej Fronti Kombëtar. Parlamenti Evropian e ka vlerësuar dëmin në 3.5 milionë euro. Ligjvënësve të BE-së u alokohen fonde për t'i mbuluar shpenzimet, përfshirë asistentët e tyre, por nuk duhet t'i përdorin

ato për t'i financuar aktivitetet partiake. Shumë parti politike evropiane - veçanërisht ato më të vogla që përfitojnë më pak financim kombëtar - kanë përdorur paratë e BE-së për të punësuar talente premtuese si ndihmës të ligjvënësve të BE-së. Udhëheqësi aktual i partisë RN, Jordan Bardella, që është gjithashtu anëtar i Parlamentit Evropian, dikur ka punuar në një rol të tillë asistent. Ai nuk është

akuzuar për keqpërdorim. Partia e Marine Le Pen - që është në grupin kryesor të partive euroskeptike dhe nacionaliste në Parlamentin Evropian dhe argumenton për politika nacionaliste në çështje që variojnë nga imigracioni, tregjet e energjisë dhe bujqësia - i mohon akuzat. Marine Le Pen përballet me akuza si për rolin e saj si udhëheqëse partie, ashtu edhe si një ligjvënëse e BE-së në atë kohë, që thuhet se ka punësuar asistentë fiktivë. Prokurorët thonë se një tjetër nga të pandehurit, Thierry Legier, në të vërtetë ka punuar si trupor për Le Pen dhe babanë e saj, Jean-Marie Le Pen, themeluesin e Frontit Kombëtar, ndërsa merrte një pagë si asistent parlamentar midis viteve 2005 dhe 2012. Ligjvënësi i RN-së dhe zëdhënësi i partisë, Laurent Jacobelli, i tha "Reuters"-it javën e kaluar se Marine Le Pen, tani ligjvënëse në parlamentin francez, nuk është e shqetësuar për gjyqin. "Ajo e di që

ajo për të cilën akuzohemi është një kuptim i ndryshëm, si një parti franceze, i asaj se çfarë është roli i një asistenti, krahasuar me kuptimin e Parlamentit Evropian", tha ai. Nëse shpallet fajtorë, Le Pen dhe të pandehurit e tjerë mund të përballen me një dënim potencial me burg deri në 10 vjet dhe një gjobë prej një milion eurosh. Përveç kësaj, ata si Le Pen që ishin zyrtarë të zgjedhur në kohën e veprave të dyshuara rrezikojnë të përjashtohen nga postet publik deri në 10 vjet. Ata që nuk ishin zyrtarë të zgjedhur mund të përjashtohen deri në pesë vjet. Prokuroria publike e Parisit hapi një hetim në vitin 2016, nxitur nga një raport i presidentit të Parlamentit Evropian drejtuar ministrit të Drejtësisë së Francës, i ndjekur nga një hetim policor. Gjyqi do të zgjasë deri më 27 nëntor. RN-ja është në një hetim tjetër paraprak, nisur në korrik nga prokuroria e Parisit, për financimin e paligjshëm të pretenduar të fushatës së saj presidenciale të vitit 2022.

Të paktën 90 të vdekur nga uragani Helene në ShBA

Helene, 30 shtator - Të patën 90 persona kanë vdekur nga uragani Helene që ka goditur pjesën juglindore të Shteteve të Bashkuara. Autoritetet po vazhdojnë operacionet e kërkimit të trupave të tjerë, teksa uragani Helene ka shkatërruar dëme të mëdha materiale, përfshirë shkatërrimin e rrugëve dhe urave dhe vërshime nga Florida deri në Virxhinia. Stuhia është karakterizuar me erëra të fuqishme dhe reshje

shiu dhe ka goditur Karolinën e Veriut, Karolinën e Jugut, Xhorxhian, Floridën, Tenesinë dhe Virxhinian. Zyrtarët kanë thënë se drujtë se do të gjejnë trupa të tjerë të pajetë. Rrjeti i komunikimit është dëmtuar në shumë zona dhe qindra njerëz ende nuk kanë mundur t'i kontaktojnë familjarët e tyre të cilët i kanë regjistruar si të zhdukur. Dëmet nga stuhia e fuqishme konsiderohen se mund të arrijnë nga 15 miliardë dollarë

deri në mbi 100 miliardë dollarë, teksa autoritetet thanë se linjat e rëndësishme të komunikimit dhe ato të transportit janë dëmtuar. Megjithatë, autoritetet thanë se vlera reale e dëmeve do të dihet pasi autoritetet të pastrojnë zonat e prekura dhe të vlerësojnë dëmet. Në Karolinën e Veriut, pothuajse të gjitha viktimat janë regjistruar në qarkun Bunkombe, ku vdiqën 30 persona, sipas autoriteteve.



Hapet thirrja për studime të doktoratës, një student do të mbështetet 8 500 euro

Prishtinë, 30 shtator - Ministria e Arsimit ka hapur të hënën konkursin për përkrahjen e studimeve të doktoratës në 500 universitetet më të mira botërore, sipas listës "Shanghai" 2024/2025. Kështu ka bërë me

dije ministria e Arsimit, Arbërie Nagavci, në "Facebook". Ajo theksoi se "vlëra e mbështetjes për një student do të jetë 8 500.00 euro", dhe kjo thirrje është e hapur për studentët e Republikës së

Kosovës. Ministria Nagavci shtoi se përparësi do të kenë ata që nuk kanë bursa të pjesshme nga ndonjë skemë brenda ose jashtë vendit, si dhe ata që studiojnë në universitetet me

rangun më të lartë ndërkombëtar. Afati i fundit për aplikim është më 14 tetor 2024. "Për studentët tanë, më shumë përkrahje e më shumë mundësi!", ka thënë Nagavci.



SBASHK-u dorëzon në Kuvend petitionin për ndryshimin e Ligjit për Skemat Pensionale

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 30 SHTATOR - Sindikata e Bashkuar për Arsim, Shkencë dhe Kulturë (SBASHK) ia ka dorëzuar Kryesisë së Kuvendit të Kosovës një petition që kërkon ndryshimin e Ligjit për Skemat Pensionale që financohen nga shteti.

Petitioni është nënshkruar nga 20 606 qytetarë.

SBASHK-u synon që përmes kësaj nisme të adresohen disa nga sfidat me të cilat përballeshin punonjësit e arsimit dhe sektorëve të tjerë publikë që përfitojnë nga skemat pensionale, duke kërkuar që të ketë ndryshime në përfitimet e pensionistëve.

Kryetari i SBASHK-ut, Rrahman Jasharaj, tha se është i sigurt që kurdo që të shkojnë në Kuvend këto ndryshime, do të miratohen, pasi tha se kanë marrë mbështetjen nga grupet parlamentare në pushtet dhe opozitë. "Pjesë e këtij projektligji tonë është që Qeveria dhe Kuvendi t'i njohin edhe vitet 2000, 2001 e deri në korrikun e vitit 2002 si kontributdhënës, pra deri në momentin kur filloi së funksionuari Trusti Pensional", tha ai për gazetaret.

Ai tha se po synohet që këta persona, që shënjestrojnë këto ndryshime, të marrin pensione të punës e jo pensione të pleqërisë, duke shtuar se vetëm në sektorin e arsimit ka mijëra të pensionuar që do të përfitonin nga ndryshime të tilla.

Ndryshimi në Ligjin për Skemat Pensionale të financuara nga shteti është kërkesë e kamotshme e sindikalistëve në Kosovë.

Më 2022 sindikalistët kishin mbajtur protesta për ta kërkuar ndryshimin e një neni të këtij ligji, përmes të cilit kërkohet që përfituesit të kenë 15 vjet kontribute pensionale para 1 janarit të vitit 1999.

Ky ligj kishte pësuar ndryshime më 5 korrik 2023, duke krijuar një skemë të re pensionale për personat që nuk e kishin plotësuar kriterin prej 15 vjetësh stazh për të përfituar nga pensioni kontributpagues.

Me krijimin e kësaj skeme të re pensionale përfitojnë njerëzit që ishin larguar nga puna pas datës 1 janar të vitit 1989 si rezultat i masave të dhunshme. Sipas këtij projektligji, lartësia e pensionit parcial kontributpagues për secilin nivel përcaktohet duke marrë për bazë numrin e viteve të kontributeve të paguara.



Jasharaj nga SBASHK-u tha se, pavarësisht se u bënë ndryshime në këtë ligj, një nen i këtij ligji prek punëtorët e arsimit dhe sektorëve të tjerë që kanë punuar gjatë viteve '90. Ai tha se disa persona nuk kanë përfituar nga pensioni kontributpagues pasi nuk e kanë arritur stazhin prej 15 vjetësh për disa ditë, apo disa javë. "Fatkeqësisht me ndryshimet në skemat pensionale që u bënë, deputetët, mbase të entuziazmuar nga lajmi se do t'u njihen vitet '90 të gjithëve, pra edhe atyre të dëbuar nga puna, e kanë bërë një

nen që i godet dhe prek vitet '90 që janë të garantuara në ligjin bazik, neni 8, pika 6. Ne jemi të sigurt që deputetët do ta përmirësojnë këtë", tha ai.

Në pikën 6 të nenit 8 të Ligjit për Skema Pensionale thuhet se u njihet "stazhi i punës për pension kontributdhënës për vitet 1989-1999 punëtorëve të arsimit, të shëndetësisë dhe të tjerëve që kanë punuar në sistemin e Republikës së Kosovës".

Ligji për Skemat Pensionale të financuara nga shteti zbatohet që nga viti 2014.

Pensionet në Kosovë sillen nga 100 deri në 265 euro.

Fondi Pensional, ku të gjithë të punësuarit kishin kontribuar deri më 1999, është përvetësuar nga Serbia.

Sipas Shoqatës së Pensionistëve, në periudhën kur në mënyrë joligjore është marrë Fondi Pensional nga Serbia, numri i pensionistëve ishte llogaritur të jetë më shumë se 89 mijë. Sipas vlerësimeve të përafërta, thuhet se shuma e Fondit Pensional të Kosovës arrin vlerën 2 miliardë euro.

Në ShBA Kurti nderohet me 'Çelësin e Qytetit' të Waterburyt



Prishtinë, 30 shtator - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka pranuar simbolin (çelësin e qytetit) nga kryetari i qytetit të Waterburyt, Paul K. Pernerevski.

Zyra e kryeministrit në njoftimin për medie thotë se simboli i është dhënë si vlerësim ndaj udhëheqjes dhe përkushtimit të kryeministrit Kurti për nxitjen e miqësisë ndërkombëtare dhe si simbol që dyert e qytetit të Waterburyt janë gjithmonë të hapura për të. "Kryetari i Qytetit të Waterburyt, Paul K. Pernerevski Jr., i dhuroi

kryeministrit të Republikës së Kosovës, Albin Kurti, Çelësin e Qytetit", thuhet në njoftim.

Kryeministri Albin Kurti, së bashku me zëvendëskryeministren dhe ministren e Punëve të Jashtme dhe të Diasporës, Donika Gërvalla-Schwarz, zëvendësministren Liza Gashi, dhe konsullin e përgjithshëm të Kosovës në Nju-Jork, Blerim Reka, u mirëpritën dhe në Qendrën Kulturore Shqiptaro-Amerikane "Hasan Prishtina" në Waterbury, Connecticut, në një organizim madhështor dhe të përzier të bashkatdhetarëve tanë.

Qeveria ndan 100 mijë euro për Koalicionin Global kundër ISIS-it

PRISHTINË, 30 SHTATOR - Qeveria e Republikës së Kosovës ka mbajtur një mbledhje elektronike, në të cilën ka marrë disa vendime të rëndësishme.

Në këtë mbledhje është emëruar Komisioni Ad hoc i Pranimit për Pozitën e Kategorisë së Lartë Drejtuese: Inspektor i Përgjithshëm, në kuadër të

Zyrës së Kryeministrit. Po ashtu, është ndarë një fond prej 100 000 eurosh për mbështetje të Koalicionit Global kundër ISIS/DAESH, duke theksuar angazhimin

e Kosovës në luftën kundër terrorizmit dhe në ruajtjen e sigurisë ndërkombëtare. Kështu është bërë me dije në njoftimin për medie nga zyra e kryeministrit.





27 vjet. Protesta studentore e 1 tetorit 1997 mobilizoi popullin

1 tetori i vitit 1997 ishte një moment kthese në historinë e Kosovës. Atëkohë studentët, profesorët dhe qytetarët i mbushën rrugët e Prishtinës. Ajo protestë pati efekt të madh sepse e gjithë bota ktheu vëmendjen te Kosova, te fati i shqiptarëve dhe shembulli se si okupatori serb vepronte mbi rininë shqiptare, se si po mudohej të shtypte çdo lëvizje e cila kërkonte drejtësi, liri dhe pavarësi për popullin shqiptar. Po ata studentë iu bashkuan edhe radhëve të UÇK-së. Studentët dhe pedagogët pjesëmarrës në protestën e 1 tetorit 1997 shënuan një faqe të ndritur të historisë së rezistencës së Kosovës drejt lirisë dhe pavarësisë

bashku me rektorin e atëhershëm të Universitetit të Prishtinës, Ejup Statovci. Pas tyre në këtë protestë ishin edhe mijëra studentë dhe profesorë, shkruan "Epoka e re".

27-vjetorin e protestës studentore të 1 tetorit të vitit 1997 e kanë kujtuar liderët e kësaj lëvizje dhe profesorë universitarë që ishin pjesë e asaj proteste.

Sot në këtë përvjetor theksohet se kjo lëvizje u bë simbol i rezistencës së rinisë dhe qytetarëve të Kosovës ndaj regjimit serb dhe u shndërrua në promotor të luftës për liri dhe pavarësi. Kjo ngjarje, thonë profesorët universitarë, duhet të shënohet në tekste shkollorë dhe të kujtohet nga gjeneratat e reja si akt sublim i fillimit të procesit të lirisë dhe pavarësisë së Kosovës.

Ish-kryetari i Lëvizjes Studentore, Bujar Dugolli, në emisionin "Voyage" të RTK-së, ka thënë se në protestën e 1 tetorit u bë një bum i madh i lëvizjes së përgjithshme të Kosovës për liri dhe pavarësi. "Ne si brez jemi

frymëzuar nga lëvizjet e tjera, nga '68 dhe posaçërisht nga lëvizja e '81-shit, dhe normalisht që e kemi sofistikuar sistemin e organizimit dhe kërkesat fillestare me qëllim që ta zgjojmë ndërgjegjen ndërkombëtare me atë çfarë po ndodh në Kosovë", ka pohuar Dugolli, duke bërë me dije se kanë pasur vështirësi të mëdha në organizimin e kësaj proteste, nga aspektet elementare teknike deri tek ato politike. "Kishte ardhur koha që populli e dëshironte një lëvizje", ka thënë Dugolli, duke shtuar se kjo protestë e studentëve e mobilizoi popullin.

Muhamet Mavraj, një nga drejtuesit e Lëvizjes Studentore, ka thënë se më 1 tetor është mposhtur frika e Kosovës, ka rënë miti i frikës dhe secili shqiptar është ndier mirë dhe më solidar me tjetrin. "Me një fjalë, u rikthye vlera tradicionale. Përvjetorët e 1 tetorit ushqejnë një impuls krenarie, natyrisht, por na bëjnë t'i kujtojmë shumë shokë tanët dëshmorë", ka theksuar Mavraj.

Edhe Driton Lajçi, një nga

drejtuesit e kësaj lëvizje, ka thënë për "Voyage" të RTK-së se kjo ngjarje duhet të rifreskohet për audiencën, sidomos për gjeneratat e reja. "Në Kosovë në vitin 1997 dhe 1998 ka pasur shumë 1 tetor për lirinë e Kosovës", ka thënë ai, duke treguar se ishin bërë gjashtë javë parapërgatitje për këtë protestë, me takime të ndryshme, qoftë politike dhe fetare. "Sensibilizimi ishte shumë i madh", ka thënë Lajçi.

Mentor Hasani, historian, ka theksuar në "Voyage" të RTK-së se studiuesit e huaj kanë potencuar se kjo protestë ka pasur impakt shumë të madh në zhvillimet politike dhe në pasqyrimin e gjendjes në Kosovë. "Lëvizja Studentore e '97-s e ka bërë dallimin", ka thënë ai, duke shtuar se ka qenë një protestë gjithëpopullore.

Profesori dhe ish-reaktori i UP-së, Arsim Bajrami, një nga organizatorët e kësaj proteste, ka deklaruar më herët për gazetën "Epoka e re" se protestat e 1 tetorit të vitit 1997 ishin një momente kthese dhe fillim i

EPOKA E RE**Mal QORRAJ**

PRISHTINË, 30 SHTATOR - Sot janë mbushur 27 vjet nga protesta e Lëvizjes Studentore e vitit 1997. Ishte Lëvizja Studentore e atëhershme që organizoi protestat të cilat u organizuan për ta kundërshtuar pushtimin e Kosovës nga Serbia dhe kthimin e studentëve në objektet universitare, nga të cilat studentët ishin dëbuar nga regjimi i Slobodan Millosheviqit në fillim të viteve '90.

Përpos masave të dhunshëm që regjimi kishte vendosur vite më parë në universitet, dëboi studentë dhe profesorë nga universiteti dhe imponoi planprogramin serb për mësim. Kjo protestë konsiderohet një ndër aktet më të rëndësishme të asaj kohe. Për ta shpërndarë protestën paqësore, policia serbe përdori dhunë ndaj studentëve dhe profesorëve.

Në ballë të kësaj proteste ishin liderët e Lëvizjes Studentore, Bujar Dugolli, Muhamet Mavraj, Driton Lajçi dhe Albin Kurti, së

thyerjes së Serbisë dhe ish-Jugosllavisë në Kosovë.

“Këto protesta thyen mitin e pamposhtëmërisë së Serbisë, duke i dhënë fund nënshtrimit dhe rezistencës paqësore si një kushtrim lirie, që u bë realitet me luftën heroike të UÇK-së”, ka thënë ai.

Bajrami ka thënë se duke kujtuar



përvjetorin e kësaj proteste madhështore, kur studentë e profesorë u bënë bashkë kundër robërisë, sot kujtojmë me pietet rektorin e atëhershëm të UP-së, Ejup Stavovci dhe udhëheqësit e studentëve.

Edhe ish-rektori i Universitetit të

Prishtinës dhe një nga pedagogët pjesëmarrës në protestën e 1 tetorit 1997, Ibrahim Gashi, ka theksuar për gazetën “Epoka e re” se protestat studentore të vitit 1997, veçmas ajo e 1 tetorit, paraqesin nivelin më të artikuluar të joviolencës aktive në lëvizjen e deritashme politike të shqiptarëve të Kosovës.

“Shumë studiues e cilësuan atë si zëvendësim të lëvizjes paqësore pasive me një veprim joviolent aktiv. Efektet e këtij veprimi të vendosur të studentëve ishin të menjëhershme. Me këtë lëvizje studentore u bë mjaftueshëm e qartë se çdo formë e rezistencës

paqësore, sado e organizuar në mënyrë përfekte, përballë regjimit okupues serb do të ngelë pa efekte. Faktori ndërkombëtar që kishte interesim për zhvillimet në Ballkan dhe në Kosovë nga kjo lëvizje studentore e kuptoi seriozitetin e situatës shpërthyesë dhe qartësoi pozicionet e veta karshi palëve rivale. Edhe faktori vendor u ndërgjegjësua se lëvizja paqësore e rezistencës nuk mund të prodhonte më asnjë efekt konkret për përmbytjen e platformave politike të shqiptarëve të Kosovës ndaj dhe gradualisht pas kësaj lëvizjeje po hapet perspektiva për një strategji të luftës së armatosur midis palëve. Krejt në fund, me të drejtë mund të konstatojmë se protestat studentore të vitit 1997 janë hallka e fundit e lëvizjes së rezistencës paqësore, e cila arriti të lidhet, mbase edhe të shndërrohet në hallkën e parë të rezistencës së armatosur të UÇK-së, e cila e vitalizoi, i dha shpirt dhe e sendërtoi platformën e Kosovës për çlirim dhe shtet të pavarur. Pikërisht këtu qëndronte rëndësia e kësaj lëvizjeje historike studentore dhe si e tillë do të zërë vend në historinë e re të Kosovës”, ka thënë Gashi.



Kaja Kallas në vend të Borrellit, çfarë e pret Kosovën në dialog?

Prishtinë, 30 shtator - Estonezja Kaja Kallas, e cila shpejt pritet ta zëvendësojë Josep Borrellin si shefe e re e politikës së jashtme e Bashkimit Evropian, mund të jetë më e ashpër, por në raport me Kosovën mund të ketë qasje pak më pozitive.

Për Borellin dhe Lajçakun, kryeministri Albin Kurti u ankua se kur ka shkelje nga Serbia nuk i bien bilbil.

Por në fushën e dialogut shumë shpejt do të ndërrohen referat.

Rolin e arbitrit në kostumin e shefit të politikës së jashtme të Bashkimit Evropian, në vend të spanjollit Josep Borrell do ta luajë estonezja Kaja Kallas, politikania që deri në korrik të këtij viti ishte kryeministre e Estonisë. “Zonja Kallas si shefe e Jashtme do të jetë

shumë më e ashpër, por për të gjitha palët, kështu që është referë shumë e mirë, por nuk kisha qenë shumë entuziast në kuptimin e asaj sepse obligimet që i kemi ne, nuk mund t’u ikim, pavarësisht kushdo që vjen refer”, ka deklaruar për “TV Dukagjinin” profesori Dritëro Arifi.

Profesori universitar thotë se nga mesi i tetorit do të definojnë gjërat dhe do të hapet një dialog brenda Komisionit Evropian ku pritet që Kallas ta shpalosë vizionin e saj. Krahas saj, sipas Arifit, më e rëndësishme është që Bashkimi Evropian ta rihapë një dialog tjetër brenda tij, në mënyrë që të tërhiqet nga neutraliteti dhe ta pranojë Kosovën shtet që faktikisht ekziston.

Me gjithë ndryshimet në



hierarkinë e bllokut evropian, analisti Visar Ymeri, përpos një qasje pak më pozitive, nuk pret ndryshime radikale pasi që, sipas tij, vendet anëtare e kanë timonin në duar. “Unë mendoj edhe çka

kisha pas dëshirë me e pa është që me ardhjen e zonjës Kallas në detyrën e saj dhe pastaj të shohim se kush po vendoset si zëvendësues i Lajçakut, se do të ketë më shumë trysni karshi

Serbisë, ose së paku propozime për t’iu shtuar trysnia Serbisë për ta zbatuar pjesën e vet të marrëveshjes. Psh. ne jemi në sanksione si Kosovë dhe e dimë pse jemi në sanksione. Të mos sillemi sikur nuk e dimë. Në anën tjetër, Serbia është përgjegjëse për sulmin në Banjskë për të cilin nuk ka marrë asnjë lloj ndëshkimi”, ka deklaruar Ymeri, sipas të cilit, “në sytë e ndërkombëtarëve nuk është vetëm Serbia pala që nuk po i zbaton marrëveshjet”.

Estonezja Kallas është takuar disa herë me liderët e Kosovës dhe njihet për qëndrime pro integritetit të Ballkanit Perëndimor në BE, kritike e Rusisë dhe dashamirëse e rolit të NATO-së në Evropë.

Bashkëpunimi me aleatët: Ndikimi juridik, diplomatik dhe strategjik në forcimin e sovranitetit të brendshëm dhe të jashtëm të Kosovës



Shkruan:
Prof. Dr. Fejzulla
BERISHA

Në procesin e forcimit të sovranitetit të Kosovës, bashkëpunimi ndërkombëtar me aleatët ka qenë determinant për përballimin e sfidave të brendshme dhe të jashtme, për konsolidimin e institucioneve shtetërore dhe për avancimin e statusit ndërkombëtar të Kosovës. Ky proces është zhvilluar në dy dimensione kryesore: juridik dhe diplomatik, duke përfshirë krijimin e një baze të fuqishme ligjore për pavarësinë dhe zgjerimin e njohjeve ndërkombëtare.

Konsolidimi i Shtetit përmes Kuadrit Ligjor. Kushtetuta e Kosovës (2008). Pas shpalljes së pavarësisë më 17 shkurt 2008, Kosova miratoi Kushtetutën më 15 qershor 2008, e hartuar në konsultim të ngushtë me ekspertë ndërkombëtarë dhe me mbështetjen e Kombeve të Bashkuara (UNMIK) dhe Bashkimit Evropian (BE). Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe BE-ja

luajtën një rol kyç në krijimin e këtij dokumenti themelor, i cili reflekton parimet ndërkombëtare të sundimit të ligjit dhe mbrojtjes së të drejtave të njeriut. Kushtetuta vendosi bazën për ndërtimin e institucioneve të pavarura si Gjykata Kushtetuese dhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve etj, duke siguruar një sistem demokratik të mbështetur në sundimin e ligjit.

Mbrojtja e të drejtave të pakicave. Kushtetuta përmban dispozita të avancuara për mbrojtjen e të drejtave të pakicave etnike, me fokus të veçantë tek komuniteti serb dhe grupet e tjera etnike, duke reflektuar angazhimin e BE-së për pajtimin etnik. Ky kuadër është esencial për sigurinë e brendshme dhe stabilitetin e Kosovës, duke ndihmuar në forcimin e legjitimitetit të saj të brendshëm dhe ndërkombëtar.

Përballja me sfidat juridike ndërkombëtare. Një sfidë kritike për Kosovën ishte kontestimi ndërkombëtar i shpalljes së pavarësisë nga Serbia, që kulmoi në mendimin këshillues të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë (GJND) më 2010. Me mbështetjen e fuqishme të aleatëve perëndimorë, Kosova mbrojti me sukses legjitimitetin e shpalljes së saj të pavarësisë, me GJND që vendosi se shpallja nuk binte në kundërshtim me të drejtën ndërkombëtare, duke

dhënë mbështetje juridike për zgjerimin e njohjeve ndërkombëtare.

Reformat në sistemin e drejtësisë dhe sundimi i ligjit. Kosova ka implementuar reforma të rëndësishme për të ndërtuar një sistem të drejtësisë funksional, në përputhje me normat ndërkombëtare dhe evropiane. Misioni i BE-së për Sundimin e Ligjit (EULEX) ka luajtur një rol të rëndësishëm në mbështetjen dhe mbikëqyrjen e reformave, duke ndihmuar në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, si dhe në sigurimin e respektimit të të drejtave të njeriut. Njohjet diplomatike dhe anëtarësimet në organizata ndërkombëtare. Që nga shpallja e pavarësisë, Kosova ka marrë njohje nga më shumë se 100 shtete, duke përfshirë njohje dhe anëtarësimet në institucione të rëndësishme financiare ndërkombëtare si Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN) dhe Banka Botërore etj. Megjithatë, Kosova ende përballet me rezistencë nga disa shtete, veçanërisht nga Rusia dhe Kina, të cilat bllokojnë anëtarësimin e saj në Kombet e Bashkuara (OKB).

Një nga sfidat diplomatike më të rëndësishme për Kosovën është dialogu me Serbinë, i ndërmjetësuar nga BE-ja. Marrëveshjet si ajo e Brukselit në vitin 2013 kanë ndihmuar në arritjen e një njohjeje praktike të

disa institucioneve të Kosovës nga Serbia, duke përfshirë policinë dhe gjyqësorin. Ky dialog është kyç për avancimin e procesit të integritetit të Kosovës në BE dhe për perspektivën e anëtarësimin në OKB.

Integrimi në Bashkimin Evropian dhe NATO. Kosova ka bërë hapa të rëndësishëm drejt integritetit evropian me Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit (MSA) të nënshkruar në vitin 2015, e cila krijon një kornizë për zhvillimin ekonomik dhe politik në përputhje me standardet e BE-së. Nga ana tjetër, NATO ka luajtur një rol kyç në garantimin e sigurisë përmes misionit KFOR dhe mbështetjes për zhvillimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), duke përgatitur vendin për një anëtarësim të mundshëm në të ardhmen.

Mbështetja në diplomacinë ndërkombëtare. Kosova ka përfutur nga përkrahja diplomatike në arritjen e marrëveshjeve ekonomike dhe tregtare me vendet fqinje dhe partnerët strategjikë. Bashkëpunimi ndërkombëtar përmes këtyre marrëveshjeve ka qenë vendimtar për forcimin e sovranitetit të saj të brendshëm dhe të jashtëm. Forcimi i sovranitetit të Kosovës në bashkëpunim të ngushtë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA) dhe Bashkimin Evropian (BE) ka qenë një proces i

rëndësishëm për konsolidimin e shtetësisë dhe integritetin ndërkombëtar të vendit.

Roli i ShBA-ve ka luajtur një rol kyç në mbrojtjen dhe mbështetjen e Kosovës, duke përfshirë angazhimin diplomatik dhe ushtarak përmes NATO-s, dhe duke mbështetur integritetin e saj ndërkombëtar.

Përmes investimeve në infrastrukturë, ndihmës ekonomike dhe këshillave për reformat politike, ShBA ka kontribuar në forcimin e institucioneve të Kosovës dhe në avancimin e saj drejt sovranitetit të plotë. Angazhimi i BE, nga ana tjetër, ka udhëhequr përpjekjet për integritetin e Kosovës në strukturat evropiane përmes dialogut të lehtësuar me Serbinë dhe duke ofruar perspektivën e integritetit në BE. Marrëveshjet e Brukselit, ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, të mbështetura nga BE, janë shembuj të këtij bashkëpunimi. Reformat e nevojshme për anëtarësim në BE kanë ndikuar në fuqizimin e sundimit të ligjit dhe në zhvillimin ekonomik. Përpjekjet për forcimin e sovranitetit të Kosovës janë shoqëruar me marrëdhënie të ngushta diplomatike me vendet fqinje dhe partnerët bashkëpunimi strategjik me ShBA dhe BE do të jetë vendimtar për arritjen e njohjes së plotë ndërkombëtare dhe integritetin e qëndrueshëm të Kosovës në strukturat euro-atlantike.

UP-ja organizon ligjëratë nderi për zbulimin arkeologjik në Ulpianë (Iustiniana Secunda)

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 30 SHTATOR - Rektori i UP-së, prof. Qerim Qerimi, ka mirëpritur në takim arkeologun e mirënjohur francez nga École Normale Supérieure dhe CNRS në Paris, prof. Christophe J. Goddard, profesorin Arben Hajdari nga Departamenti i Historisë dhe Antropologjisë së UP-së dhe Milot Berishën nga Instituti Arkeologjik i Kosovës.

Prof. Goddard po qëndron në Kosovë, ku është ftuar në ligjëratën e organizuar nga Universiteti i Prishtinës në nderim të zbulimit të fundit arkeologjik të përmasave historike, jo vetëm për Dardaninë, por për tërë historinë e periudhës romake dhe atë të sundimit të Perandorit Justinian. Në kuadër të kësaj ligjërate u prezantuan për herë të parë për publikum rezultatet e kërkimeve të fundit ndërdisiplinore arkeologjike të kryera në Ulpianë nga një ekip arkeologësh dhe studiuesish, vendas dhe ndërkombëtarë, të udhëhequr nga Arben Hajdari (UP), Christophe J. Goddard (AOROC-

CNRS-ENS) dhe Milot Berisha (IAK).

Në këtë rast u prezantua për herë të parë dedikimi unik i themelimit të një qyteti (Iustiniana Secunda) nga perandori Justinian dhe gruaja e tij Theodora, zbuluar së fundmi në Iustiniana Secunda (Ulpianë), dokument ky me rëndësi dhe vlerë të veçantë historike, jo vetëm për Kosovën e rajonin, por për mbarë botën romake.

Të pranishëm në ligjëratë ishin edhe ambasadorë, profesorë, studiues e studentë të arkeologjisë dhe të drejtëve të tjera.

Rektori Qerimi, në shenjë vlerësimi, i ndau mirënjohje prof. Christophe J. Goddard, me motivacionin: "Mirënjohje për angazhim dhe kontribut të veçantë në avancimin e dijes arkeologjike në Kosovë, si dhe për rolin e rëndësishëm në edukimin dhe formimin e kuadrove të rinj në këtë fushë".

Po ashtu, në emër të UP-së, mirënjohje iu nda edhe prof. Arben Hajdarit dhe z. Milot Berisha me motivacionin: "Mirënjohje për angazhim dhe kontribut të veçantë në



avancimin e dijes arkeologjike në Kosovë, si dhe për rolin e rëndësishëm në edukimin dhe formimin e kuadrove të rinj në këtë fushë".

Kjo ligjëratë është vazhdimësi e organizimeve të ngjashme në funksion të krijimit të një forumi dhe ofrimit të një platforme për paraqitjen dhe vlerësimin e

rezultateve origjinale kërkimore dhe kontributeve me peshë shkencore të stafit akademik të UP-së dhe bashkëpunëtorëve e partnerëve të tyre.

Limaj me bashkëpunëtorë shkon për ngushëllime te familja Ilazi në Ferizaj

FERIZAJ, 30 SHTATOR - Kryetari i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, bashkë me anëtarë të Kryesisë së Nismës dhe bashkëpunëtorë, kanë

shkuar të hënën për ngushëllime te familja Ilazi në Ferizaj, pas ndarjes nga jeta të gjeneralit të UÇK-së dhe FSK-së, Imri Ilazi. "Imriu

do të mbetet në kujtesën tonë si një patriot e një person i jashtëzakonshëm me vlera të mëdha njerëzore. Edhe një herë i shpreh ngushëllimet

më të sinqerta familjes, miqve dhe gjithë bashkëluftëtarëve të të ndjerit!", ka shkruar Limaj në "Facebook".



NATO dislokon trupa në Kosovë dhe Maqedoni të Veriut

PRISHTINË, 30 SHTATOR - Pothuajse 200 trupa nga Forcat e reja Aleate të Reagimit (ARF) do të dislokohen në Kosovë dhe në Maqedoninë e Veriut nga 30 shtatori deri më 16 tetor për stërvitje që synojnë "gatishmërinë e tyre dhe mbështetje për KFOR-in". Kështu njoftoi NATO-ja më 30 shtator, duke thënë se kjo është hera e parë që forca të ARF-së do të dislokohen, që kur kjo forcë u krijua në korrik të vitit 2024.

Në Kosovë do të dislokohen 50 trupa të Ekipit Operacional të Ndërlidhjes dhe Zbulimit (OLRT) të ARF-së, ndërkaq 150 të tjerë në Maqedoninë e Veriut. "Personeli i dislokuar do t'i performojë aktivitete stërvitore për të mbajtur në nivel të lartë gatishmërinë dhe për t'i testuar aftësitë e tyre dhe procedurat për dislokim të shpejtë të një force të madhe. Një pjesë e selisë së ARF-së do të integrohet përkohësisht në komandën dhe strukturat kontrolluese të misionit të KFOR-it dhe do të ketë për detyrë t'i identifikojë kërkesat e mbështetjes logjistike, mbështetjen infrastrukturore dhe operacione për KFOR-in në rast të nevojës për një përforsim të pranishëm të KFOR-it", u tha në njoftim.

Sipas NATO-s, ARF-ja është një forcë strategjike, e gatishmërisë së lartë me aftësi të shumë fusha. Kjo forcë mund të dislokohet shpejt dhe mund të ofrojë ndihmë në mbrojtje në skenarë të ndryshëm. NATO tha se dislokimi i fundit, së bashku me dislokimet e bëra më herët gjatë këtij muaji në Kosovë



të Forcave Strategjike Rezervë (SRF), dërgojnë "mesazh të qartë të vendosmërisë të fortë të NATO-s dhe përkushtimit për ta ruajtur paqen dhe stabilitetin në rajon, por edhe aftësinë e aleancës dhe

gatishmërinë për t'u përgjigjur". Së fundi, në Kosovë janë dislokuar trupa të Britanisë për të marrë pjesë në stërvitje me trupat e misionit paqeruajtës të aleancës ushtarake perëndimore në

Kosovë, KFOR. Ndryshe, KFOR-i është reaguesi i tretë i sigurisë në Kosovë, pas Policisë së Kosovës që është e para dhe pas misionit të BE-së për sundim të ligjit, EULEX.

Misioni i NATO-s në Kosovë, po ashtu, është përgjegjës për sigurinë e kufijve të Kosovës me Serbinë, ndërsa pjesën tjetër të vijës kufitare e mbikëqyr Policia e Kosovës.

Komuna e Prishtinës liron nga pagesa e trafikut urban invalidët e luftës së UÇK-së



PRISHTINË, 30 SHTATOR - Komuna e Prishtinës ka njoftuar se ka marrë vendim për lirimin nga pagesa e trafikut urban për invalidët e luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Lirimi nga pagesa do të bëhet nga data 1.10.2024. "Obligohen organet drejtuese të NPL 'Trafiku Urban' SHA që në

bashkëpunim me Shoqatën e Invalidëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës - Dega Prishtinë, t'i ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe fillon të zbatohet nga data e përcaktuar në


pikën 2 të këtij vendimi. Arsyetim: Ky vendim nxirret sipas kërkesës së Shoqatës së Invalidëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës - Dega Prishtinë, si mbështetje institucionale për këtë kategori të lartësuar të luftës tonë çlirimtare", ka njoftuar komuna e Prishtinës.

FSK-ja përfundon ushtrimi fushor "Iron Platoon"

PRISHTINË, 30 SHTATOR - Në kuadër të ngritjes së kapaciteteve të këmbësorisë dhe planifikimit vjetor, K1B e Regjimenti i Parë i Këmbësorisë ka realizuar ushtrimin fushor "Iron Platoon". Ushtrimi kishte për qëllim

përfundimin e qitjeve dhe manovrave me municion real në nivel togu, operacione sulmuese dhe sulm në objektivë, ku janë përdoruar sistemet e armatimit të togut të manovrës. Në ushtrim janë marrë për

bazë mësimet e mësuara nga Operacioni "INTERFLEX", me specifikisht: luftimet nëpër pozicione luftuese (transhe), reagimi i parë në fushëbetë, taktikat dhe teknikat individuale të luftimit.



Hapësirat e gjelbra publike, 'Ec Ma Ndryshe': 15 komuna me performancë në mesatare

PRISHTINË, 30 SHTATOR - Hapësirat e gjelbra publike kanë ndikim pozitiv në shëndetin dhe në mirëqenien e grupeve të ndryshme të komunitetit që jetojnë në qytete.

Nga "Ec Ma Ndryshe" përmes një njoftimi për medie kanë bërë me dije se edhe pse studimet tregojnë se dobitë e këtyre hapësirave janë të shumanshme, të dhënat e publikuara në Raportin e Performancës së Komunave të Kosovës për vitin 2023 tregojnë se në këtë fushë ka nevojë për përmirësime të mëtejme.

Më tutje thuhet se matja e vitit 2023 është realizuar në 16 fusha të kompetencave komunale, me gjithsej 93 tregues. "Elementet e matjes së performancës shprehin grupin e të drejtave dhe obligimeve që komunat i ushtrojnë në shërbim të qytetarëve mbi bazën e kompetencave ligjore. Indikatorët e përdorur japin informacione të konsiderueshme për nivelin e shërbimeve të ofruara. Të dhënat e fituara, sipas Raportit, japin indikacione të rëndësishme për menaxhmentin e komunës për t'i shtrirë prioritetet në sektorët më pak të zhvilluar. Ato ndihmojnë që komunat ta përmirësojnë planifikimin dhe t'i orientojnë prioritetet e tyre në sektorët e nevojshëm për vitet e ardhshme. Sistemi, sipas Raportit, shërben edhe për autoritetet qendrore për të planifikuar dhe orientuar politikat në sektorët në nevojë, sipas vlerësimeve reale, kritereve të qarta, ashtu që shpërndarja e



investimeve të bëhet në mënyrë të drejtë dhe objektive", thuhet në njoftim.

Në këtë raport, sipas "Ec Ma Ndryshe" janë paraqitur disa fusha të performancës me nevojë të madhe për rritjen e performancës. "Në mesin e tyre figuron edhe hapësira publike. Në kuadër të fushës hapësira publike janë matur hapësirat publike të cilat janë me interes për qytetarët, menaxhohen nga komunat dhe të cilat ndikojnë në cilësinë dhe standardin e jetesës së qytetarëve". Performanca e përgjithshme, sipas të dhënave të ofruara nga komunat, është 51.59 për qind. "Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, komunat, ndër të tjera, janë kompetente për ofrimin dhe mirëmbajtjen e parqeve dhe hapësirave publike.

Sipas të dhënave të raportuara nga komunat në nivel maksimal prej 100-përqindësh janë 4 komuna të cilat e kanë ofruar këtë shërbim për qytetarët e vet, ndërsa për 6 komuna ende mbetet sfida ofrimi i këtij shërbimi dhe si rrjedhojë janë vlerësuar me 0", shkruan në raport.

Nga "Ec Ma Ndryshe" thonë se komunat Ferizaj, Dragash, Junik dhe Suharekë kanë arritur performancë maksimale me 100 për qind, derisa nën mesataren prej 51.59-përqindësh janë renditur Prizreni, Mitrovica, Kamenica, Vitia, Fushë-Kosova, Peja, Malisheva, Shtimja, Podujeva, ndërkohë që Deçani, Gjilani, Parteshi, Prishtina, Shtërpca dhe Mitrovica Veri janë vlerësuar me 0. "Sipas një

publikimi të vitit 2022 të Agjencisë Evropiane të Mjedisit, hapësirat e gjelbra janë të rëndësishme për mirëqenien e qytetarëve. Aty thuhet se hapësirat e tilla me cilësi të lartë, si parqet, kopshtet dhe brigjet e lumenjve janë thelbësore për shëndetin dhe mirëqenien e qytetarëve, sidomos të moshuarve, fëmijëve dhe atyre me të hyra të ulëta, meqë këto grupe të komunitetit kanë mundësi më të kufizuara për të qenë në kontakt me natyrën. Prandaj edhe sqarohet se si njerëzit i përdorin këto hapësira të gjelbra për ushtrime fizike e ndërveprim social, por edhe për qetësi mendore. Ndërkaq për dobitë thuhet se ato nisin prej uljes së rrezikut të obezitetit të fëmijët dhe shkojnë deri te

shëndeti më i mirë kardiovaskular e shkallë më të ulëta të depresionit të të rriturit", thuhet tutje në njoftim.

Po ashtu, krahas kësaj, parqet, drunjtë dhe hapësirat e tjera të gjelbra përmirësojnë cilësinë e ajrit, reduktojnë zhurmën, ofrojnë freski gjatë ditëve të nxehta dhe përforcojnë biodiversitetin në zonat urbane. "Pabarazia në ofrimin e këtyre hapësirave apo qasjes në to ekziston edhe në Evropë, ku qytetet në veri dhe në perëndim kanë tendencë që të kenë më shumë hapësira të tilla në krahasim me ato në jug dhe lindje të Evropës. OBSH-ja ka rekomanduar se njerëzit duhet të banojnë së paku brenda distancës prej 300 metrave (ecje 5 minutësh) nga hapësirat e gjelbra, ndërkohë që ato duhet të jenë të qasshme për të gjitha grupet e komunitetit".

Prandaj, "EC Ma Ndryshe" rekomandon komunat e Kosovës, sidomos ato që kanë treguar performancë në nivelin mesatar në fushën e hapësirave publike gjatë vitit 2023 që të ndërmarrin hapa për përmirësime të dukshme në këtë fushë, gjithnjë duke i zbatuar edhe praktikatat e mira në këtë drejtim.

Bazuar edhe në përvojat e deritanishme, EC u bënë thirrje komunave ta përfshijnë komunitetin si në dizajnimin ashtu edhe për menaxhimin e këtyre hapësirave me qëllim të përmirësimit të nevojave të grupeve të ndryshme të komunitetit, por edhe përforcimit të ndjenjës së pronësisë.

Gërxhaliu: Subvencionohen pajisjet për ngrohje me energji elektrike në kohën kur paralajmërohet krizë energjetike dhe ngritje e çmimeve

PRISHTINË, 30 SHTATOR - Ish-kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, Safet Gërxhaliu, ka thënë se në vitet e fundit, Kosova po përballlet me një paradoks, ku Qeveria e Kosovës subvencionon qytetarët për blerjen e pajisjeve elektrike për ngrohje, ndërsa vendi përjeton krizë të theksuar energjetike dhe ngritje të çmimeve të energjisë elektrike. "Kjo politikë, në vend që ta zgjidhë problemin, përkeqëson situatën duke rritur konsumin e energjisë dhe varësinë nga importet e shtrenjta. Gjatë dimrave të kaluar Kosova ka përjetuar reduktime të energjisë që kanë prekur rëndë qytetarët dhe ekonominë, në veçanti sektorin privat. Me temperaturat e ulëta që parashikohen, rritja e konsumit të energjisë do të kërkojë blerje më të shtrenjta nga jashtë. Kjo politikë duket e qëllimshme, duke shkruar në



favor të disa aktorëve vendorë dhe rajonalë dhe që thëllon varësinë energjetike të vendit nga importet e shtrenjta", ka thënë ai, duke shtuar se derisa shtetet e Ballkanit Perëndimor,

por edhe më gjerë kanë luftuar për investime në burime energjetike për prodhim deri edhe në ndërtimin e centraleve bërthamore në Kosovë, që nga pas lufta më shumë është

investuar për ta penguar ndërtimin e kapaciteteve të reja energjetike sesa për t'i shfrytëzuar resurset natyrore që ka Kosova. "Në vend se të investojë në alternativa të

qëndrueshme si prodhimi i peletit, qeveria shkatërron një industri vendore që ka filluar të lulëzojë, duke favorizuar pajisje të importuara për ngrohje me energji elektrike. Kjo jo vetëm që dëmton industrinë e prodhimit të peletit në vend, por edhe rrit deficitin tregtar të Kosovës. Prodhimi i peletit në vend ka potencial të madh për ta ulur varësinë nga importet dhe për të krijuar një cikël ekonomik të brendshëm. Megjithatë, qeveria nuk duket të ketë një plan për uljen e këtij deficit tregtar, duke e thelluar atë edhe më tej. Në një kohë kur vendet e tjera përpiqen ta ulin varësinë energjetike dhe t'i mbështesin industritë vendore, Kosova po ecën në drejtimin e kundërt. Nëse kjo politikë nuk ndryshon, qytetarët dhe ekonomia e Kosovës do të përballen me sfida të mëdha në këtë dimër, por edhe në vitet që vijjnë", ka thënë Gërxhaliu.

U ZHVILLUA CEREMONIA E DORËZIMIT TË TITULLIT “QYTETAR NDERI” PËR PROF. DR. EQREM ZENELAJ (PARIS MEMAJ) PËR KONTRIBUTIN AKADEMIK, SHKENCOR DHE KOMBËTAR

Bashkia e Pukës nderon figurën e Prof. Dr. Eqrem Zenelaj me titullin më të lartë të qytetit

Në këtë veprimtari morën pjesë shumë personalitete të botës intelektuale dhe akademike nga e gjithë hapësira mbarëshqiptare, në mesin e të cilëve edhe deputeti i Zonës së Pukës në Parlamentin e Shqipërisë – z. Lodovik Hasani



FADIL HYSENI
(Kabash) Pukë

Në një atmosferë sa festive, aq edhe solemne u zhvillua ceremonia e dorëzimit të titullit: “Qytetar Nderi” i Bashkisë së Pukës për prof. dr. Eqrem Zenelaj akorduar nga Këshilli i Bashkisë.


Veprimtaritë filluan me pritjen zyrtare nga zëvendëskryetari i Bashkisë së Pukës, z. Ferit Ringaj, i cili i uroi mirëseardhje prof. dr. Eqrem Zenelajt dhe delegacionit shoqëruar, si dhe kërkoi mirëkuptimin e tyre për mospjesëmarrjen e kryebashkiakut në këtë ceremonie, për shkak të impenjimeve dhe agjendës së ngjeshur të minutave të fundit. Më pas veprimtaria u vendos në mjediset e Muzeut Etnokulturor, ku të pranishëm ishin intelektualë, drejtues institucionesh e qytetarë të shumtë, të cilët për 90 minuta

ndoqën nga afër këtë event, që erdhi përmes moderimit të regjisorit, Fran Vukaj dhe ndërthurjes së kumtesave, referateve e përshëndetjeve të miqve dhe delegacionit bashkëshoqëruar të profesor Eqremi.

Pas përfundimit të intonimit të himnit kombëtar, ceremonia filloi me fjalët përshëndetëse të zëvendëskryetarit, z. Ferit Ringaj, i cili përveç të tjerash theksoi bashkëpunimin e Bashkisë së Pukës me botën akademike.

Në vazhdim, Dod Luli një bashkëpunëtor i kahershëm i profesor Eqremi u ndal më tepër në aktivitetin akademik, ku i njohu të pranishmit me disa nga botimet më të rëndësishme të profesor Eqremi.

Në vijim të solemnitetit, me referimet e tyre u paraqitën: z. Ramë Manaj, ish-zëvendëskryeministër i Parë i Republikës së Kosovës; z. Ibrahim Gashi, ish-zëvendësministër i jashtëm i Qeverisë së Republikës së Kosovës; gjeneral Hisen Berisha – njëri ndër komandantët më të



Prof. Dr. Eqrem Zenelaj
(Paris Memaj)
“QYTETAR NDERI”



zot të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës; z. Ismail Dibrani – Drejtor i Përgjithshëm i Shërbimit Korrektues të Republikës së Kosovës; z. Ded Prenga, gjeneral në Shqipëri; z. Ismet Kallaba, profesor nga Ulqini dhe pedagog në Universitetin “Luigj Gurakuqi” të Shkodrës, etj., të cilët vlerësuan vendimin e Këshillit Bashkiak të Pukës për shpalljen “Qytetar Nderi” për profesorin Eqrem Zenelaj, duke theksuar se ky ishte fundi i një krenarie kombëtare.

Më pas, kryetari i Këshillit Bashkiak të Pukës, z. Gjon Gjoka, pasi lexoi motivacionin për titullin “Qytetar Nderi” për profesorin Eqrem Zenelaj, foli për punën e palodhshme dhe shumë frytdhënëse të profesorit Zenelaj dhe më pas e shpalli profesorin Eqrem Zenelaj “Qytetar Nderi” i Bashkisë së Pukës.

Si iniciuesi dhe propozuesi i



shpalljes, deputeti i Zonës së Pukës në Parlamentin e Shqipërisë – z. Lodovik Hasani pohoi krenarinë e këtij vlerësimi dhe shprehu mirënjohjen për të gjithë anëtarët e Këshillit Bashkiak të Pukës.

Tejet i emocionuar, profesor Eqrem Zenelaj në përshëndetjen e tij përcolli një mesazh bashkëkombësve për ruajtjen e vlerave kombëtare dhe unitetin në mes të njëri -

tjetrit.

Krejt në fund, aktiviteti u mbyll me një repertor artistik nga Qendra Kulturore e Fëmijëve të Bashkisë së Pukës.

2 Lista e delegacionit nga Kosova

1. Prof. dr. Eqrem Zenelaj,
2. Ramë Manaj, ish-Zëvendëskryeministër i Parë i Qeverisë së Republikës së

Kosovës,

3. Prof. dr. Ibrahim Gashi, ish-Zëvendëskryeministër i Jashtëm dhe ish-riktor i Universitetit Shtetëror “Hasan Prishtina” në Kosovë,

4. Gjeneral Rustem Berisha, ish-Ministër i Mbrojtjes së Republikës së Kosovës-komandant i përgjithshëm në luftën e Koshares 1998/1999,

5. Gjeneral Hisen Berisha-komandant lufte i frontit në vijën e parë të luftës në Koshare, më

1998/1999,

6. Mr. sci. Ismail Dibrani-Drejtor i Përgjithshëm i Shërbimit Korrektues të Republikës së Kosovës,

7. Ismet Kallaba nga Ulqini - pedagog në Universitetin “Luigj Gurakuqi” të Shkodrës,

8. Mr. sci. Edmond Demiri (Ulqin) -udhëheqës i sektorit juridik dhe përfaqësues ligjor i Ndërmarrjes Publike të Veprimtarisë Komunale në Ulqin,

9. Sami Ahmeti (pronari i hotelit

“Sirius”),

10. Sedat Zenelaj (djalë vëllai i prof. dr. Eqrem Zenelaj),

11. Zeqir Zenelaj (kushëri i prof. dr. Eqrem Zenelaj).

Nga Shqipëria

12. Ambasadori - Mal Berisha,

13. Ambasadori - Arben Çejku,

14. Gjeneral Ded Prenga,

15. Fran Tuci,

16. Dod Luli.

17. Sadri Buçpapaj



Udhëtimet e Çelebiut në Shqipëri



Nga: Franz BABINGER
Përktheu: Eqrem ÇABEJ

Një vlerë të madhe kanë shënimet e udhëtarit Evlija Çelepi [Evliya Çelebi, 1611-1682], në veprën e tij të njohur e prej dhjetë blejsh "Libri i shtegtimt" (Sejahatneme) përmbi Shqipërinë, të cilën duket se e ka shëtitur më se një herë. Lajmet mbi Shqipëri ndodhet në blenin e VII-të e të VIII-të.

Kurse nga përshkrimi që na jep ai mbi Shqipërinë veriore nuk del një gjë e madhe për ta njohë më mirë atë vend; vlera e përshkrimit të Shqipërisë jugore e të mesme prej tij qëndron më lart. Ky shtegtim nëpër Shqipëri që ay e bëri në verën e vitit 1670, u lidh me një udhëtim nëpër Greqi të veriut. Evlijai erdhi prej ujdhesës Leukas në Prevezë, në Prevezë të vjetër, d.m.th. në Nikopolis, gjer në gërmadhat e Rogóit, pastaj në Nartë, Janinë, Zaravuci, Ajdonat (Paramithi), Margëlliç, Pargë, Lopës, Sajadhë, në kala të Dajlanit përballë Korfuzit, në Korfuz e prej Korfuzi zbriti prapë në tokë për në Delvinë.

Evlijai thotë se Delvina ra për herë të parë në dorë të turqvet më 1431 në kohë të Bajazidit të II-të, po për gjithmonë në kohë

të Sulejmanit të Shkëlqyer, kur e pushtoi shqiptari Ajas Pasha. Q'atëherë është qëndra e një Sanxhakbeut. Një gjyqtar ushtron detyrën e vet. Në majë të një bregu të rëpjete qëndron një kështjell i fortë pesë këmbësh. Nga lindja hapet një port' e hekurt. Përbrënda ndodhen vetëm tri shtëpi të vogëla e të mbuluara me tjegulla për të zotin e kështjellit, për qehajanë dhe për imamin, pastaj një xhami e vogël, një drithërishte a kocek, një xhephane si edhe një sterrë.

Më të djathtë të kështjellit ndodhet Xhamija e Hungjarit, xhami katër këmbësh e gurtë, e cila që ndërtaur prej Bajazidit të II-të. Pazari ka vetëm 80 dyqane. Shtëpitë e Delvinës janë të përndara, nj'a një pushkë larg njëra-tjetrës. Ndër xhami të tjera janë për t'u përmëndur xhamija në lagjen Vlladika e xhamija në Gjini-Aleks; kishte edhe gjashtë medrese, tri shkolla për të vegjël, tri teqe bektashinjsh, një hamam dhe tre hane, nga të cilët më i dukuri është hani i Memo Pashës. Së fundi Delvina kishte 12 kronje. Lagja Vllaka ndodhet më ulët, lagja Gjini-Aleks gjëndet në mes të kopshtijeve e të vreshtave. Sidomos që madhështor seraj i Memo Pashës.

Në Delvinë q'atëherë bëheshin

limonet, portokallat, fiqtë, ullinjte, shegët, kishte edhe shumë selví. Banorët flasin vetëm shqip dhe greqishten s'e kuptojnë. Të heqë vërejtjen tmerri që kanë prej murtajës, që është aq i madh, sa, kur pëlçet kjo sëmundje, i lënë të sëmurët dhe marrin malet; kështu, të lënë, vdesin si qeni në vreshtë, edhe në qoftë se nuk i pat zënë murtaja. Tregëtija kryesore është eksportimi i ullinjve.

Prej Delvine Evlijai udhëtoi nga perëndimi dhe pas 7 orësh rruge nëpër shkrepë e male arriti në Kalasë, e cila ndodhet në veriperëndim të Delvinës në rrëzë të Kurveleshit dhe hyri në sundimin e Perandorisë Otomane nga dora e Gedik Ahmet Pashës në kohë të Bajazidit të II-të. Pasha i Delvinës merr të ardhura prej atij vëndi. Kështjelli i Kalasës ka po atë madhësi sikundër ay i Delvinës.


Prej Kalasës Evlijai eci 7 orë rrugë nëpër udhë të gurta nga veriu dhe arriti në Zhulát. Ky vend që pushtuar prej Gedik Ahmet Pashës edhe përbën që prej Sulejmanit të II-të e këtej një vojvodí të sanxhakut të Delvinës. Kështjelli i vogël, po shumë i fortë ka një periferí prej 400 hapash. Ndërmjet lindjes e perëndimit ka një portë.

Prej Zhulati Evlijai mori anën e lumit të Kardhiqit nga lindja

dhe arriti në Kardhiq, i cili më vonë (në Shkurt të 1812-ës) mori një emër të hidhët me gjakderdhjen që bëri Ali Pashë Tepelena. Ky vënd aso kohe që i rrethuar prej një muri dhe qëndronte mbi një kodër. Kishte 150 shtëpi të vobekta të mbuluara me tjegulla pjesërisht dhe me pllaka e me kashtë. Në Kardhiq ndodhesh një kumandant me 100 veta.

Prej kënde Evlijai mori prapë udhën e lumit nga lindja dhe arriti pas 6 orësh në Tërbuq, Labovë, Kakoz, gjithë çifliqe të beut të Delvinës, Memo Pashës. Atëhere erdhi në Gjinokastër, në qytetin më me rëndësi të Shqipërisë jugore, të cilit Evlijai i kushton një përshkrim të gjerë. Gjinokastra u-pushtua prej Bajazidit të II-të vetë (1431). Që prej Sulejmanit Gjinokastra i takon Pashës së Delvinës. Mbi një kurriz të gjatë mali zgjatesh kështjelli madhështor, i cili kishte një përqarkje prej 1400 hapash. Anët e gjata kishin një madhësi prej nga 600 hapash, anët e shkurtëra 100. Përbrënda mureve ndodheshin 200 shtëpi shumë katesh e të mbuluara me pllaka guri, edhe një xhami e ndërtaur prej Bajazidit të II-të. Ujë e së pirit mirresh nga një sterrë (saranxhë), ishte ujë shiu. Në lagjen e kalasë hyhesh nga dy porta të trifishta hekuri. Në

Varosh ndodhesh, si edhe sot, lagja e të Krishterëvet me 200 shtëpi. Në qytet ndodheshin dy pazare të mbyllura me porta të drunjta. Në lagjen Memi Bej gjëndeshin 150 shtëpi të forta. Qyteti i madh shtrihesh mbi 8 brigje dhe lugina; atje ngriheshin me radhë shtëpi shumë katesh me kulla. Gjinokastra atëhere kishte 8 lagje, ndër të cilat më të parat ishin: Palo, Verosh, Manalat, Haxhi bej, Dondar, Memi Bej. Këto lagje përmblihdnin 2000 shtëpi, ndër të cilat shquheshin seraj i Memi Pashës si dhe pallatet e parësisë. Në Gjinokastër ndodheshin atëhere tri teqë bektashinjsh. Mjerisht mbi këto nuk jep shënimë të imta. Pesë kronje i jepnin ujë qytetit. Banorët e Gjinokstrës kanë, kështu tregon ky udhëtar, një frikë të madhe nga murtaja. Nga pikëpamja folkloristike vlejné të shënohen përshkrimet e dokevet dhe të zakonevet të banorëvet të këtij qyteti. Në disa ditë feste, në dasma, synetllëqe, si dhe në ditën e Hidrit, d.m.th. të Shën Gjergjit (23 Prill allaturka), në Nevruz, në Kasim, d.m.th. ditën e Sari Salltëkut (ndofta Shën Kollí) banorët veshin petka ari, pinë verë të kuqe dhe kërcejné valle të çudiçme, duke u-përqafuar, duke u-zënë për brezi, etj.



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

Ribeiro, 'Ylli i javës' në Superligë: Synojmë titullin e kampionit

PRISHTINË, 30 DHJETOR - Federata e Futbollit të Kosovës dhe sponsori i Superligës, Albi Mall, vazhdojnë ta japin çmimin "Ylli i javës". Ky çmim për javën e shtatë në Albi Mall Superligë i është ndarë futbollistit të FC Ballkani, Giovanni Manson Ribeiro. Vlerësimi i më të mirit të javës është bërë nga Komisioni i Veteranëve të Futbollit, i përbërë nga Agim Xhakolli, Bujar Asllani dhe Rifat Nasufi. Ky komision vendosi që çmimi "Ylli i Javës" për xhiron e shtatë t'i takojë Giovanni, i cili për 78 minuta dhuroi spektakël në fushë. Giovanni shënoi dy gola unike për fitoren e FC Ballkanit kundër FC Ferizajt, ndeshje kjo që përfundoi me rezultatin 4:0. Pasi mori këtë çmim, Giovanni u shpreh i lumtur që u vlerësua më i miri i javës. "Jam shumë i lumtur që arrita të shënoj këtë gol me biçikletë. Ishte një gol shumë i bukur. Fillimisht, dua ta falënderoj Zotin dhe ekipin e trajnerëve që më kanë ndihmuar çdo ditë për ta përmirësuar lojën time. Jam shumë i lumtur që shënova këto dy gola. Tani duhet të vazhdojmë të punojmë, sepse kemi një ndeshje shumë të vështirë të dielën. Gëzimi po rritet vit pas viti, prandaj jam shumë i lumtur. Duhet të vazhdojmë të



punojmë gjatë kësaj jave, për të bërë një ndeshje të madhe të dielën dhe për të punuar për një kampionat të mirë, që në fund të shpallemi kampionë. Fillimisht dua të falënderoj Zotin që jam përzgjedhur 'Ylli i javës', trajnerët e mi, shokët e ekipit, presidentin dhe të gjithë ata që janë pjesë e ekipit. Pa

ndihmën e tyre asgjë nuk do të ishte e mundur. Ne do të vazhdojmë të punojmë. Ballkani ka pasur tre vjet që është shpallur kampion dhe do të vazhdojmë të punojmë, duke mbajtur fokusin, për t'u shpallur kampionë çdo vit që vjen", ka thënë ai për faqen zyrtare të FFK-së.

Kuka: Ambasadori Hovenier do të jetë me ne në Olimpiadën e ardhshme



Pejë, 30 shtator - Ambasadori i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Jeffrey Hovenier, ka vizituar xhudistët e Kosovës në Qendrën Nacionale të Xhudos në Pejë. Trajneri Driton Kuka ka bërë me dije se Hovenieri i ka uruar për medaljet olimpike të fituara deri më

tash, pesë sosh, kurse ka zbuluar edhe premtimin që ka marrë nga ai. "Premtoi që do të jetë me ne në Los Angeles 2028 në Olimpiadën e ardhshme", ka shkruar Kuka në "Facebook". "Si gjithmonë afër nesh miku ynë ambasadori i USA Hovenier. Erdhi t'i uroj medaljet e reja

olimpike për shtetin tonë. Premtoj se do të jetë me ne në Los Angeles 2028 në Olimpiadën e ardhshme për të na përkrahur. Ne i shprehëm mirënjohje për vizitat që i bën ekipit tonë për të na inkurajuar drejt sukseseve të reja", ka shtuar Kuka.

SHKURT

Rrahmani: Herët të flasim për titull

Napoli fitoi dhe mori vendin e parë në Serinë A. Mbrojtësi shqiptar Amir Rrahmani është shprehur i kënaqur me atë që ka arritur. Mbrojtësi i skuadrës napolitane foli për "Rai Sport". "Fitoret dhe rezultatet janë falë të gjithë ekipit. Ne kemi qëndrimin e duhur dhe kjo bën diferencën. Është e vërtetë që vitin e kaluar e humbëm këtë, por këtë vit po e rizbulojmë, ashtu siç po rizbulojmë mekanizmat si t'i ndihmojmë shokët tanë, t'i bëjmë lëvizjet e duhura dhe shumë faktorë që na duhen për të luajtur mirë. Në këtë kohë të shkurtër po mësohemi me stile dhe module të ndryshme të lojës. Jemi futbollistë profesionistë dhe duhet të mësohemi me këto gjëra", ka thënë Rrahmani. "Vendi i parë në renditje? Është shumë herët për të bërë krahasime me sezonin e 'Scudetto'-s. Ne ende duhet të përballemi me shumë skuadra të forta për të kuptuar se në çfarë niveli jemi", ka deklaruar Rrahmani.

Provokon babai i Djokoviçit: Kosova është zemra e Serbisë

Srdjan Djokoviç, babai i tenistit serb Novak Djokoviç, ka bërë një deklaratë provokuese në "Sputnik", televizionin rus që transmetohet në Serbi. I ftuar për të folur për fëmijërinë dhe karrierën e djalit të tij si tenist, Djokoviç është lëshuar në deklaratat nacionaliste, duke thënë se Kosova është zemra e Serbisë. "Kosova është zemra e Serbisë. Kjo nuk është një plaçkë. Kjo është e vërteta sepse pa Kosovën ne jemi pluhur, një hapësirë boshe. Ne thjesht nuk ekzistojmë. Ashtu si Jerusalemi është për hebrejtë ose Meka dhe Medina për myslimanët ose Vatikani për katolikët - për ne është Kosova", ka provokuar babai i tenistit serb që njihet edhe si nacionalist i madh. Madje ai i ka vënë zjarr edhe më shumë deklaratës së tij në televizionin rus, duke thënë se "Kosova nuk do të njihet kurrë si pjesë e ndarë nga Serbia".

Paqarada në formacionin e javës të Bundesligës 2

Futbollisti i Kombëtares së Kosovës, Leart Paqarada, është futur në formacionin e javës në Bundesliga 2. Paqarada dje zhvilloi një paraqitje fantastike në barazimin 4:4 kundër Karlsruher. Mbrojtësi i krahut të Kolnit i realizoi katër asistime në këtë ndeshje. Faqja e njohur e statistikave, Sofascore e ka futur në 11-shën më të mirë të javës futbollistin e Kosovës, duke e vlerësuar me notën 8.5. Formacioni: Reimann, Paetow, Neumann, Halstenberg, Kratten, Bilbija, Sahin, Paqarada, Burcu, Wanitzek, Sylla.

Suspendohet Joshua

Anthony Joshua është suspenduar për 28 ditë nga boksi pas humbjes së tij brutale nga Daniel Dubois javën e kaluar. Largimi i përkohshëm u bë sipas protokollit, raporton "Daily Mail". Boksieri britanik gjatë ndeshjes me kundërshtarin 27-vjeçar u eliminua në raundin e pestë në "Wembley" para 96 mijë tifozëve. Dubois ruajti titullin e tij në peshën e rëndë IBF me fitore mbresëlënëse, duke rrëzuar katër herë kundërshtarin e tij. Suspendimi i përkohshëm nuk ka gjasa ta pengojë Joshuan duke pasur parasysh se kundërshtari i tij i ardhshëm nuk është caktuar ende pasi ai këmbënguli se do të vazhdojë të boksojë.

Mediet zvicerane: Amir Saipi ka vendosur ta përfaqësojë Kosovën

LUGANO, 30 SHTATOR - Mediet zvicerane kanë konfirmuar se portieri shqiptar Amir Saipi ka vendosur ta përfaqësojë Kosovën dhe jo Zvicrën. Këtë e ka bërë me dije më saktësisht mediumi "Corriere Del Ticino", i cili ka konfirmuar se numri një i gjigantit zviceran Lugano

ka vendosur ta veshë fanellën e "Dardanëve". 24-vjeçari për shumë kohë kishte qenë zgjedhja e parë e portës për grupmoshat U21 të Zvicrës, teksa edhe përzgjedhësi Murat Yakin e kishte ftuar disa herë te kombëtarja A. Saipi i lindur në Schaffhausen ka pasaportë të

dyfishtë, por që shkaku i konkurrencës së madhe te Zvicra nuk ia doli t'i gjejë hapësirat e nevojshme. Duke marrë parasysh përvojën që ka Saipi në kampionatin zviceran si dhe falë paraqitjeve me Zvicrën, do të jetë një përforcim tejet i madh për

Kosovën dhe do ta rrisë si kualitetin ashtu edhe konkurrencën. Përndryshe, Kosova do t'i luajë dy ndeshje gjatë muajit tetor, ndaj Lituanisë në udhëtim dhe ndaj Qipros në "Fadil Vokrri" në kuadër të Ligës së Kombeve. Deri atëherë mbetet të shihet



se a do të ketë zhvillime të reja por që, sipas raportimeve nga Zvicra, kjo punë tashmë mund të konsiderohet si e kryer.

Dy super ndeshje në Ligën e Kampionëve: Leverkusen - Milan dhe Arsenal - PSG

LEVERKUSEN, 30 SHTATOR - Nëntë ndeshje të Ligës së Kampionëve do të zhvillohen sonte (e martë). Këto janë ndeshjet e dyta, derisa vëmendja kryesore pritet të jetë në derbin mes Bayer Leverkusenit dhe Milanit. Kampionët e Gjermanisë ku luan shqiptari Granit Xhaka kanë shënuar fitore në ndeshjen e parë dhe tash në "BayArena" kërkojnë fitoren e dytë ndaj Milanit që e nisi jo mirë sezonin në Ligën e Kampionëve duke u mposhtur në "San Siro". Tash kuqezinjtë kërkojnë tri pikët e para në garën më të fortë, derisa janë të motivuar pas dy fitoreve radhazi në Serinë A kundër Interit dhe Lecces.

Trajneri i Bayer Leverkusenit, Xabi Alonso, në konferencë për shtyp për ndeshjen e Ligës së Kampionëve kundër Milanit, në "Bay Arena", ka thënë se klubi që ai e drejton është gati të përballet me një ekip të madh siç është Milani. "Ne do të përballemi me një ekip të madh, me cilësi individuale. Ne do të kemi nevojë për paraqitjen tonë më të mirë në fushë, jemi gati. Nuk kemi pasur shumë kohë për t'u përgatitur, por mirë është edhe kështu. Të luash kundër skuadrave italiane është gjithmonë e vështirë, duhet durim i madh me



posedimin e topit, sepse ata janë gjithmonë të gatshëm të mbrojnë ulët, në të njëjtën kohë mbrojnë mirë. Stili i Paulo Foncesas është i qartë. Ata kanë një ide dhe modul të përcaktuar. Do të shohim se çfarë lloj ndeshjeje do të luajmë, por ne duam të jemi protagonistë. Jemi gati", ka thënë Anloso. Ndeshje interesante do të jetë edhe ajo në mes të Arsenalit dhe Paris Saint-Germain. Arsenali është në kërkim të fitores së parë në Ligën e Kampionëve, pasi në përballjen e parë në Bergamo kundër Atalantës luajti baras (0-0). Në fundjavë e mposhti Leicester City (4-2) dhe synon të vazhdojë me fitore ndaj një klubi shumë të fortë siç është

PSG-ja. Kampionët e Francës janë në formë të mirë edhe përkundër largimit të Kilyan Mbapes në verë. Ndeshjen e parë francezët e fituan me mund të madh ndaj Gironës (1-0), derisa në fundjavë në Ligën 1 e mposhti Stade Rennais (3-1).

TË MARTËN TAKOHEN:

18:45 Salzburg - Brest
18:45 Stuttgart - Sparta Prague
21:00 Arsenal - Paris Saint-Germain
21:00 Barcelona - Young Boys
21:00 Bayer Leverkusen - Milan
21:00 Borussia Dortmund - Celtic
21:00 Inter - Crvena Zvezda
21:00 PSV Eindhoven - Sporting CP
21:00 Slovan Bratislava - Manchester City

Hamiltoni zbulon betejën e gjatë me depresionin

LONDËR, 30 SHTATOR - Shtatë herë kampioni i Formulës 1, Lewis Hamilton luftoi me depresionin për vite të tëra që në moshë të re, pasi u përball me presionin e ndjekjes së një karriere në motorsport dhe u përball me ngacmimet në shkollë. Hamiltoni, i cili ka garuar në gara që kur ishte gjashtë vjeç, ka thënë se ai ka luftuar me depresionin si i rritur dhe e ka pasur të vështirë ta nisë udhëtimin e tij. "Unë mendoj se ishte presioni i garave dhe vështirësive në shkollë si dhe ngacmimi. Nuk kisha me kë të flisja", ka thënë Hamilton për "The Times". "Kam luftuar me shëndetin mendor gjatë jetës sime,



depresionin që në moshë shumë të hershme kur isha, për shembull, 13-vjeçar kur isha e deri në të njëzetat, kisha disa faza vërtet të vështira", ka shtuar ai. Hamiltoni bëri debutimin e tij në Formula 1 në vitin 2007 kur ishte 21 vjeç, duke u bërë piloti i parë me ngjyrë. Ai fitoi kampionatin vitin e ardhshëm dhe plotësoi rekordin e

Michael Schumacherit prej shtatë kampionateve në vitin 2020. Britaniku më pas ka thënë se ndihet më i pjekur sot sesa ishte më herët në karrierën e tij. "Ju po mësoni për gjërat që ju janë transmetuar nga prindërit tuaj, duke vënë re ato modele, si reagoni ndaj gjërave, si mund t'i ndryshoni ato. Pra, ajo që mund të më ketë zemëruar në të kaluarën nuk më zemëron sot. Unë jam shumë më i rafinuar", ka deklaruar Hamiltoni. Piloti i Mercedesit, i cili do t'i bashkohet Ferrarit vitin e ardhshëm, është i gjashti në kampionat, me garën e radhës të vendosur në Austin muajin e ardhshëm.

Griezmanni pensionohet nga Kombëtarja e Francës

Antoine Griezmann ka njoftuar se e ka marrë vendimin për t'u pensionuar nga Kombëtarja e Francës. Sulmuesi i rrezikshëm kështu i jep fund përvojës 10-vjeçare me "Trekolorët".

Futbollisti i Atletico Madridit e zbuloi këtë vendim sot në mëngjes para ndeshjeve të "Les Bleus" në tetor kundër Izraelit dhe Belgjikës. Griezmanni ka luajtur në gjashtë

turne të mëdhenj me Francën, duke e përfshirë rolin kyç që e kishte në Botërorin 2018, të cilin e fitoi Franca, por ishte pjesë e kësaj Kombëtareje edhe në rrugëtimin deri në finale të

Botërorit 2022 në Katar. "Me zemrën plot me kujtime, vendosa që ta mbyll këtë etapë të jetës sime. Faleminderit për këtë aventura magjike me "Trekolorët" dhe shihemi së

shpejti", ishte një pjesë e postimit të futbollistit në rrjetin social, "Twitter". Ish-futbollisti i Barcelonës ndalet së luajturi për Kombëtaren pasi i shënoi 44 gola në 137 ndeshje.

SHKURT

Besa Famgas e fiton bindshëm derbin ndaj Kastriotit

Besa Famgas nisi ndeshjen me seri 4:0 dhe më pas e fitoi bindshëm derbin ndaj Kastriotit. Të dielën mbërma në palestrën "Karagaçi" në Pejë, Besa fitoi ndaj skuadrës ferizajase me rezultat 38:26. Ndeshja i takoi xhiros së tretë të Superligës së Kosovës në hendboll. Për Besën është fitorja e dytë rresht. Kastrioti e luajti ndeshjen e parë këtë kampionat. Dy ndeshjet e para nuk i ka zhvilluar ende për shkak të angazhimeve në gara evropiane. Ekipi pejan herët krijoi epërsi 9:3 e 10:4. Ferizajasit u afruan deri në katër gola, por jo më shumë. Olsi Mulaj ishte më efikas te Besa Famgas me 11 gola. Nga gjashtë i kishin Vladimir Stanković e Jakub Cwieka. U dallua sidomos portieri Mursel Mehmeti me pritje të shumta. Deniz Terziqi i shënoi 10 gola për Kastriotin. Pesë i kishte Lulzim Shabani. Po të dielën, Lapi fitoi 41:28 ndaj Trepçës. Ardi Halili i shënoi 12 gola për Llapin, kurse nga gjashtë i kishin Blerton Hasani e Arbër Neziri. Amar Mujka i shënoi 12 gola për Trepçën.

Ancelotti: Vështirë ta pranosh një barazim të tillë

Real Madridi barazoi në derbin ndaj Atletico Madridit (1-1). Trajneri Carlo Ancelotti është shprehur i zhgënjyer me golin e pranuar në minutën e fundit shtesë. Ai ka thënë se është vështirë të pranohet një barazim i tillë. "Është e vështirë të pranosh një barazim të tillë në një kohë kur je kaq pranë fitores. Atletico është një rival i fortë, me cilësi. Goli i tyre erdhi në minutën e fundit. Është për të ardhur pasi po e kontrollonim mirë lojën dhe ishim kaq pranë fitores", u shpreh Ancelotti.

Ten Hag nuk frikësohet nga shkarkimi i mundshëm

Trajneri i Manchester Unitedit, Erik ten Hag, ka këmbëngulur se ai nuk ka frikë të shkarkohet pavarësisht prej humbjes së rëndë 3-0 në shtëpi ndaj Tottenham Hotspurit. I pyetur nëse ai është i shqetësuar se "shefat" e tij të Manchester Unitedit mund të kërkojnë ta ndryshojnë menaxherin, Ten Hag ka thënë se: "Unë nuk po mendoj për këtë. Ne morëm vendimin nga një rishikim i qartë se çfarë duhet të përmirësojmë dhe si duam të ndërtojmë një skuadër, por e dinim se do të kërkonte pak kohë. Na duhet pak kohë. Ne jemi të gjithë në një drejtim. Edhe pronarët, stafi dhe lojtarët nuk e kam atë shqetësim".

McGregor në bisedime për dy duele me boksierin e pamposhtur Crawford

Kampioni irlandez i arteve marcialë mikse, Conor McGregor, ka deklaruar se është në bisedime për të zhvilluar dy duele me boksierin amerikanin Terence Crawford. Sipas "The Notorius", një sfidë do të jetë në kafaz dhe një në ring. Për momentin nuk ka asnjë konfirmim zyrtar për një marrëveshje mes palëve, por duket se boksieri i pamposhtur amerikan (41 fitore, 0 humbje) nuk ka dëshirë të duelojë në kafaz. Për këtë arsye është në dilemë dhe mund të refuzojë. McGregor është ende duke pritur të rikthehet në kafaz pas një periudhe të gjatë pa duel, që pas dëmtimit në eventin UFC 264 (korrik 2021). Irlandezi, ish-kampion i dyfishtë i botës, shtyu rikthimin e planifikuar në eventin UFC-303 ndaj Michael Chandler, për shkak të një dëmtimi në gisht. Crawford konsiderohet si një nga boksierët më të mirë në botë për momentin, ndaj dhe McGregor tha se ishte në bisedime me të, për një marrëveshje të mundshme me dy ndeshje: Në MMA dhe boks. McGregor pretendon se do të kishte qenë një luftë me vlerë "qindra miliona" dollarë, por Crawford duket se nuk është i bindur. Irlandezi ka zhvilluar vetëm një duel në ring, atë të humbur me KO teknik ndaj Floyd Mayweather, sfidë e zhvilluar në gusht të vitit 2017.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook  www.facebook.com/gjejpuneshpejite

RESTAURANT



SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156  +386 49 848 553

PRISHTINË

THIRRJE PËR APLIKIM

Kompania **"Sofije Veseli" Sh.p.k.** kërkon një ofertues/kontraktor apo kompani të interesuar dhe të kualifikuar që të dorëzojë një ofertë/propozim për furnizim dhe montim të komplet **sistemit kundër breshërit në plantacionin e mollës në sipërfaqe prej 2.5 Ha.**

Kompanitë e interesuar duhet të kontaktojnë direkt te përfituesi **"Sofije Veseli B.I."** nëpërmjet e-mailit apo telefonit, për të kërkuar një Ftesë për Kuotim tek adresa e cekur më poshtë.

Ftesat për Kuotim mund të merren më së largu deri me 5 Tetor 2024.



Përfituesi: Kompania **"Sofije Veseli B.I."**

Adresa: Mitrovicë

Telefoni: +383(45) 364 151

E-maili: sfijeveseli@gmail.com

Ofertat/propozimet duhet të dorëzohen tek adresa e përfituesit më së largu deri me 15 Tetor 2024.

REPUBLIKA E KOSOVËS
Republika Kosovo
Republic of Kosovo

Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

NJOFTIM PËR ANULIM TË KONKURSIONIT

Zyra Kombëtare e Auditimit njofton se anulohet konkursi i shpallur në dy medie vendore, në faqen zyrtare të internetit dhe në tabelën e shpalljeve të ZKA-së me datën 3 korrik 2024, për vendin e punës:

I. Pozita: Auditor junior për auditim të performancës

Numri i referencës: RAJAP/ZKA/05-06/24

Konkursi anulohet bazuar në Vendimin nr. 1490 të datës 27.09.2024.

Prishtinë, 27.09.2024 Departamenti për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore

D. Shullhaj

OBAVEŠTENJE O OTKAZIVANJU KONKURSA

Nacionalna kancelarija revizije obaveštava da se otkazuje konkurs objavljen u dva lokalna medija, na zvaničnom sajtu i oglasnoj tabli NKR-a dana 03.07.2024. godine, za radno mesto:

I. Položaj: Junior Revizor za reviziju učinka

Broj reference: RAJAP/ZKA/05-06/24

Konkurs se otkazuje na osnovu odluke br. 1490 od datuma 27.09.2024.

Priština, 27.09.2024 Departman za upravljanje ljudskim resursima

D. Shullhaj

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Fahri Goqi nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e kl. 4 dhe diplomën e Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.
- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.
- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139
- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel: 044/171-328.
- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.
- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)
- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.
- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.
- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.
- Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroi i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.
- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.
- Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.
- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

U bënë 10 vite pa Ty



Fatime Pelaj- Mavraj

(15.06. 1936-28.09.2014)

Ti ende merr fryme pranë nesh, njëjte si dikur, kur ishim të vegjël. Kokën n'prehrin tanë natë për natë e kemi vnu, sa ninulla të bukura na ke kendu, sa shumë nanë na ke uru.

Vitet ikin e Ne prapë kokën mbrapa e kthejmë, të kërkojmë Ty, fytyrën tënde të ëmbël e të e t 'bute , ata sy që japin shumë mesazhe, ato rrudha n 'balle e ato duar të arta që flasin për mundin tanë nëpër dekada.

Ne u rritëm me Ty, mësuam shumëçka nga Ti. Ne nga ti mësuam rehatinë e botës që në shpirtin tone e ke vnue.

Me mall të kujtojnë: djemtë Avdullahu, Rizaja, Avniu. Vajzat: Rabija Nazlija dhe Shukrija, si dhe nipat, mbesat, stërnipat e stërmbesat, si dhe gjithë farefisi Mavraj nga Staradrani-Istog dhe diaspora.



MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992







ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

